




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 14.06.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 529, të datës 25.05.2021, në lidhje me kërkesën e Postës së Kosovës sh.a Nr. 01-1093/21, të datës 22.04.2021, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (f, s), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh, n), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejin e hapësirës publike për vendosjen e një kontejneri

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 529, të datës 25.05.2021, për vendosjen e një kontejneri në hapësirën publike të parkingut në oborrin e Komunës së Fushë-Kosovës, për Kompaninë publike Postën e Kosovës sh.a, për krijimin e lehtësimeve administrative të marrjes së shërbimeve publike, për qytetarët dhe institucionet komunale.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për vendosjen e kontejnerit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Postës së Kosovës sh.a
dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 14.06.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 407, të datës 28.05.2021, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (h, s), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë, n), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për themelimin e dy institucioneve të arsimit parauniversitarë në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 407, të datës 28.05.2021, për themelimin e dy institucioneve të arsimit parauniversitarë në Komunën e Fushë-Kosovës, me përshkrimin dhe strukturën si vijon:
 - 1.1 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në lagjen e Dardanisë, me tridhjetë (30) paralele dhe me njëmijë nxënës;
 - 1.2 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në lagjen e Apollonisë në anën e djathtë të rrugës magjistrale M9, me tridhjetë (30) paralele dhe me njëmijë nxënës.
2. Kryerja e çështjeve tjera, mbikëqyrja, strukturimi dhe sistemimi i personelit arsimorë, administrativ, teknik dhe sigurimi i objekteve shkollore për realizimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ndarja dhe sistemimi i personelit mësimdhënës dhe nxënësve nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno', më e madhe në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, me gjithësej nëntëdhjetë e katër paralele tani, me tremijë e katërqind nxënës dhe me një rritje të vazhdueshme të numrit të nxënësve, për arsye të migrimit të madh të qytetarëve nga vise të ndryshme të Kosovës dhe shqiptare në qytetin tonë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.06.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 603, të datës 07.06.2021, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,656,080.00€;
 - 1.2 Për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,176,483.00€;
 - 1.3 Për vitin 2024 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,748,639.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024 është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bc.skr. 92
Data/Zemra 02.07.2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 01.07.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 437, të datës 25.06.2021, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë

1. Për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve dhe regjistrimin e tyre në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, për vitin shkollor 2021/2022, në përbërje prej trembëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.2 Arjeta Jashari - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.3 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.4 Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Ali Ismaili - Përfaqësuesi i Partisë së Drejtësisë, anëtar;
 - 1.6 Lindita Jashanica Rrahmani - Drejtore e Drejtorisë së Arsimit, anëtare;
 - 1.7 Ismet Gashi - Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' anëtar;
 - 1.8 Sadri Emini - Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e 'Dardanisë' anëtar;
 - 1.9 Mimoza Kryeziu - Përfaqësuese e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e 'Apollonisë' anëtare;
 - 1.10 Sherife Aliqkaj - Përfaqësuese e Këshillit të Prindërve, anëtare;
 - 1.11 Remzie Bogujevci - Drejtore e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' anëtare;
 - 1.12 Sabri Xhigoli - Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', anëtar;
 - 1.13 Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban, anëtare.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pika një (1) e vendimit, është caktimi i rrugëve në qytetin e Fushë-Kosovës për vijueshmërinë e nxënësve në procesin edukativo-arsimorë në shkollën 'Mihal Grameno', në shkollën në lagjen e Dardanisë dhe shkollën në lagjen e Apollonisë, për vitin shkollorë 2021/2022 dhe vitet e ardhshme shkollore.

3. Ndarja e caktuar nga Grupi Punues i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës për shkollat: 'Selman Riza' dhe 'Daut Bogujevci' mbetet e njëjtë edhe për vitin shkollorë 2021-2022 deri në rishqyrtimin e saj.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIMIN
Udhëzimi: 93
Data/Bashkimi: 05.07.2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 02.07.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 655, të datës 15.06.2021, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në lidhje me kërkesën Nr. 06-580/02-0004628/21, të datës 11.02.2021 nga pala Shkelzen Berisha, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi 16, nenin 43, paragrafi 7, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M


Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare për shërim

1. Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Shkelzen Berisha nga fshati Graboc i Poshtëm, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e vajzës së tij Rajana Berisha, e cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Neuroblastoma.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ADMINISTRACIJE

Nr./aq/Br./str. 94
Data/Orari. 05.07.2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 02.07.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2021, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës
në Republikën e Shqipërisë**

1. Për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë.
2. Sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e vizitës zyrtare dhe kryerja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së
FB dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.07.2021

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr./No. 95		
Data/Date: 05.07.2021		

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 495, të datës 17.06.2021, të paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 6, nenin 7, të Ligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur Nr. 04/L-143 (Gazeta Zyrtare Nr. 02/2013), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 495, të datës 17.06.2021, për shfrytëzimin e mjeteve financiare të mësimit joformal

1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'.
2. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 14,844.94€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma 5,567.64€, në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma 9,277.30€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 02.07.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.06.2021, pas shqyrtimit të Propozimit për lirimin e subjekteve afariste nga taksa nga zgjatja e orarit të punës, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lirimin e subjekteve afariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës

1. Për aprovimin e propozimit për lirimin e subjekteve afariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri me 31.12.2021.
2. Subjektet afariste që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, lirimin nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, do ta realizojnë përmes kërkesës në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, për kohën e zgjatur pas orës 23:00h.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për lirimin nga kjo taksë komunale dhe aprovimi i kërkesave të subjekteve afariste, realizohet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

